



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

---

Numri i lëndës: 2022:219983  
Datë: 22.05.2024  
Numri i dokumentit: 05717189

Pml.nr.279/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Rasim Rasimi, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoreshen profesionale Qefsere Berisha, si procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të dënuarit D. K., nga fshati ..., komuna e L., për shkak të veprës penale “Vjedhje e rëndë” të parashikuar me nenin 315, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.510/2023, të datës 17.10.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Departamenti i Përgjithshëm, PA1.nr.1567/2023, të datës 14.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 15.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e të dënuarit D. K., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.510/2023, të datës 17.10.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1567/2023, të datës 14.02.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.510/2023, të datës 17.10.2023, të dënuarit: A. K., E. H. dhe D. K., janë shpallur fajtor për shkak të veprës penale “Vjedhje e rëndë” e parashikuar me nenin 315, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. lidhur me nenin 31 të

KPRK-së dhe ndaj secilit prej tyre është shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej nga katërqind (400) euro dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej nga një (1) viti, të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse të dënuarit: A. K., E. H., dhe D. K., nuk dëshirojnë, nuk mundën ose nuk janë në gjendje që ta paguajnë dënimin me gjobë, atëherë dënimi në fjalë do t'ju zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo njëzet (20) do t'i caktohet nga një (1) ditë burgim.

Janë detyruar të dënuarit: A. K., E. H. dhe D. K., që në emër të kërkesës pasurore juridike në mënyrë solidare të dëmtuarit A. H., t'ia kompensojnë dëmin e shkaktuar në shumën prej dymijë (2.000) euro, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Gjithashtu, janë detyruar të dënuarit e lartcekur që secili prej tyre në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga pesëdhjetë (50) euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguajnë shumën prej nga tridhjetë (30) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e PA1.nr.1567/2023, e datës 14.02.2024, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të dënuarve: A. K., E.H., dhe D. K., ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur:

- i dënuari D. K., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozimin që Gjykata Supreme e Kosovës t'i ndryshojë aktgjykimet e kundërshtuara, ashtu që ndaj të dënuarit të shqiptohen sanksione penale më të buta.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.156/2024, e datës 10.05.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit D. K., të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), si dhe pasi i vlerësoi pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe përgjigjen në kërkesë të Kryeprokurorit të Shtetit, gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

I dënuari D. K., në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se gjykatat e instancave më të ulëta nuk kanë aplikuar dispozitat ligjore të zbutjes së dënimit, në mënyrë që ndaj të tij shqiptohen dënime më të buta, duke e pasur parasysh se i njëjti e ka pranuar fajësinë qysh në seancën e shqyrtimit fillestar, është penduar thellë dhe ka shprehur keqardhje, mandej rrethanat

familjare të tij, moshën e re dhe gjendjen ekonomike, ngase i njëjti nuk është në marrëdhënie të rregullt pune. Andaj, edhe të gjitha këto rrethana, tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimeve më të buta.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se pretendimet e të dënuarit D. K., janë të pabazuara, për faktin se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as me shkelje të ligjit penal.

I dënuari D. K., nuk e specifikon konkretisht se ku qëndrojnë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe cilat dispozita ligjore janë shkelur në këtë drejtim, edhe pse kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është paraqitur edhe sa i përket kësaj arsye apo baze.

Sidoqoftë, Gjykata Supreme e Kosovës, pas analizimit të aktgjyqimeve të gjykatave të instancave më të ulëta nuk ka vërejtur ndonjë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Siç është theksuar edhe më parë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është paraqitur edhe për shkak të shkeljes së ligjit penal lidhur me dënimet e shqiptuara, përkatësisht faktin se me aktgjykimet e kundërshtuara ndaj të dënuarit D. K., janë shqiptuar dënime të larta dhe se në këtë rast nuk janë zbatuar dispozitat ligjore përkatëse të zbutjes së dënimit.

Sa i përket çështjes së shqiptimit të dënimeve, Gjykata Supreme e Kosovës rikujton se sipas dispozitës së nenit 385, paragrafi 5 të KPP-së, kur është fjala për vendimin për dënimin, shkelje e ligjit penal konsiderohen vetëm rastet kur në marrjen e vendimit për dënimin, gjykata ka tejkaluar kompetencat ligjore. Pra, me fjalë të tjera, sipas kësaj dispozite ligjore, tejkalimi i kompetencave ligjore nga ana e gjykatës me rastin e vendosjes lidhur me dënimin, konsiderohet si shkelje e ligjit penal. Ndërsa, në këtë çështje penale, gjykatat e instancave më të ulëta duke vlerësuar rrethanat përkatëse relevante, të dënuarit D. K., i kanë shqiptuar dënim me gjobë dhe dënim me burgim, brenda kufijve të parashikuar për veprën penale për të cilën i njëjti edhe është shpallur fajtor, çka do të thotë se nuk janë tejkaluar kompetencat ligjore.

Përndryshe, Gjykata Supreme e Kosovës edhe në këtë çështje penale rithekson se matja e dënimeve dhe vlerësimi i rrethanave përkatëse relevante është në kompetencë të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, varësisht nga rrethanat e rastit përkatës, ndërsa duke u bazuar në nenin 432, paragrafi 1 të KPP-së, këto pretendime në lidhje me shqiptimin e dënimeve më të buta, nuk mund të jetë arsye për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Gjithashtu, është e rëndësishme që të theksohet pikërisht se duke i zbatuar dispozitat ligjore të zbutjes së dënimeve nga nenet 71 dhe 72 të KPRK-së, ndaj të dënuarit D. K., është shqiptuar dënim me burgim nën minimumin e parashikuar me ligj për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor. Në këtë aspekt, siç është cekur edhe më lart, ndaj të dënuarit Drin Krasniqi, krahas dënimit me gjobë, është shqiptuar edhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, edhe pse për veprën penale “Vjedhja e rëndë”, të parashikuar në nenin 315, paragrafi 1,

nën-paragrafi 1.1. të KPRK-së është parashikuar dënim me gjobë dhe dënim me burgim prej tre (3) deri në shtatë (7) vjet.

Andaj, edhe nga arsyet e cekura më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar dhe pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË**

Pml.nr.279/2024, më datë 15.05.2024

Procesmbajtëse,  
Qefsere Berisha

Kryetari i kolegjit,  
Agim Maliqi